

KUVENDI KOMBËTAR I MUKJES DHE RËNDËSIA E TIJ HISTORIKE

Marrëveshja e Mukjes lindi si një nevojë e një kombi për vetëmbrojtje, për liri e bashkim, për civilizim e demokraci. Ideja e BASHKIMIT, e realizuar në Mukje, është frymë e një përpjekjeje të pandërprerë, sa e lashtë aq edhe aktuale, e lindur historikisht duke e kthyer në ndërgjegje e në forcë, lëvizje e veprim mbarëkombëtar.

Mukja është një çështje kyç në historinë moderne të Shqipërisë, por dhe një çelës për të hyrë brenda saj, për të ndriçuar e shpjeguar fenomenet e ngjarjet më të rëndësishme të asaj kohe lufte dhe të gjithë periudhës gjysmëshekullore që pasoi; është një mësim për të gjithë ata që duan të mësojnë nga historia, një mesazh i nevojshëm për sot dhe për të ardhmen.

Mukja është simbol i bashkimit dhe i ndarjes, i mirëkuptimit kombëtar dhe i mosmarrëveshjes kombëtare, i unitetit dhe i përçarjes, i lavdisë dhe i turpit, i shansit historik dhe i varrosjes tragjike, i fjalës së bekuar dhe i fjalës së mallkuar (siç u shkrua në atë kohë), i gëzimit dhe i dhimbjes së një kombi vital, po fatkeq, që mbijetoi në luftë të vazhdueshme me të tjerët, por edhe me vetveten.

Mbledhja e Mukjes, që ka dimensionet dhe vlerat e një kuvendi kombëtar, u zhvillua më datat 1-3 gusht të vitit 1943. Në një kapërcyell kohësh: në prag të kapitullimit të Italisë fashiste dhe të pushtimit gjerman të Shqipërisë; në një udhëkryq të historisë sonë: në prag të bashkimit kombëtar në luftën kundër okupatorëve, por edhe të ndarjes, të mosmarrëveshjes dhe të konfrontimit të madh brenda vetes; në një dualitet alternativash: nacionaliste apo komuniste, demokratike apo totalitariste, perëndimore apo lindore.

Për të ardhur deri në Mukje, u desh një rrugë e gjatë dhe e

mundimshme e forcave kombëtare, të cilat, të shqetësuar për fatet e Shqipërisë e të kombit në kushtet e pushtimit, kërkonin një zgjidhje, një levë të brendshme për t'i përballuar. Kjo levë ishte kodi shqiptar i bashkimit në rrezik, veprimi i organizuar mbarëshqiptar.

Edhe në vitet e Luftës së Dytë Botërore, sidomos përgjatë vitit 1943, kudo, në çdo familje, fshat, qytet e krahinë të vendit, si edhe në diasporë, flitej e shkruhej për nevojën e domosdoshme të bashkimit të të gjithë shqiptarëve për të përballuar kushtet e rënda të pushtimit italian dhe, veçanërisht, të bashkimit për të përballuar një pushtues tjetër më të egër, i cili kishte bërë daljen e parë në Shqipëri. Pra, në prag të mbledhjes së Mukjes, bashkimi ishte një kërkesë mbarëkombëtare, një imperativ i kohës, një thirrje e një diktimit i një populli që donte të dilte me çdo kusht nga vorbulla në breg, nga pushtimi në liri.^[1]

Që të realizohej kjo gjë, duhej të arrihej marrëveshja dhe bashkëpunimi midis dy grupimeve më të mëdha politike dhe ushtarake të asaj kohe: Frontit Nacionalçlirimtar dhe Ballit Kombëtar, organizata që secila kishte platformën dhe programin e vet, formën e organizimit dhe të veprimit politik, strukturat e formacionet ushtarake respektive, të ndërhuara kryesisht në çeta e batalione e në taktikë të luftës partizane, luftë që kishte shënuar deri atëherë përpjekje të rëndësishme çlirimtare si nga ana e formacioneve vullnetare nacionaliste, ashtu edhe nga ato partizane. Pas tyre qëndronin forca shoqërore të caktuara nga gjithë shtresat e qytetit dhe të fshatit, që kishin gjeografinë e tyre të përcaktuar politike e krahinore, madje brenda një fshati ose familjeje.

Ky imperativ i kohës për bashkëpunim mbarëshqiptar është reflektuar në takimet, në bisedat dhe në përpjekjet e luftërat e përbashkëta e deri te tratativa për formimin e një Komitetit të Koordinimit midis Ballit Kombëtar dhe Frontit Nacionalçlirimtar.

Sipas kompromisit të arritur midis këtyre organizatave, në fillim të vitit 1943 filloi puna për formimin e komisioneve të bashkërendimit të veprimeve luftarake. Bashkëpunimi nisi në trevat më nacionaliste, si: Vlora, Kolonja, Mallakastra, Devolli, Gjirokastra, Librazhdi, dhe u shtri edhe në krahinat e tjera të

[1] Foreign Office 371/37144 Dokumente.

vendit. ^[2]

Po a ishte e mundur një marrëveshje kombëtare?

Po.

Së pari, sepse në këtë moment kritik bashkëpunimin e kërkonin të gjithë shqiptarët e ndershëm e patriotë. Bashkimi ishte bërë nevojë e vullnet i një kombi. Në mos në Mukje, diku tjetër do të kryhej ky akt madhor, i mbarsur në kohë. Në Konferencën pluraliste të Pezës u hodhën themelet e bashkimit në luftën kundër okupatorëve fashistë, ndonëse ky bashkim nuk mundi të realizohej si u vendos në Pezë, për shkak të mosfunksionimit si front dhe të manipulimit nga ana e PKSh-së që iu bë Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, si edhe këshillave nacionalçlirimtare, të cilat u dominuan nga një forcë e vetme politike.

Së dyti, sepse të dy grupimet kryesore të rezistencës antifashiste: Fronti Nacionalçlirimtar dhe organizata e Ballit Kombëtar, e konsideronin okupatorin si armik, shkelës së sovranitetit dhe të pavarësisë së Shqipërisë dhe, si i tillë, ai duhej luftuar.

Së treti, deri në Mukje grupimet kryesore politike ende e konsideronin njëri-tjetrin si partnerë, pjesë të një procesi apo vetëm si kundërshtarë politikë, por jo si armiq. Fakti që gjatë vitit 1943 ishin nënshkruar e arritur mjaft marrëveshje lokale dhe kërkohej me insistim nga populli dhe nga përfaqësuesit e të dy organizatave në bazë që ky mirëkuptim të vendosej edhe në qendër, fakti që deri në gusht të vitit 1943 çetat nacionaliste dhe ato partizane në përgjithësi nuk erdhën në përpjekje të armatosur midis tyre, madje zhvilluan mjaft beteja të përbashkëta, vërtetoi frymën ekzistuese të mirëkuptimit e jo të konfrontimit.

Së katërti, sepse tradita dhe ndërgjegjja nacionaliste ishte ende dominante kudo në Shqipëri, ndërsa komunizmi i importuar ishte ende i sipërfaqshëm e i paasimiluar, ndaj trysnia kombëtare në përgjithësi ishte zotëruese, ashtu siç u provua edhe në Konferencën e Mukjes. Deri në atë kohë, shpirtin e dy grupimeve kryesore e përbënin nacionalistët demokratë që ndikuan dhe luftuan për afrimin, bashkëpunimin dhe marrëveshjen midis Frontit Nacionalçlirimtar dhe organizatës së Ballit Kombëtar.

Së pesti, sepse zgjidhja e çështjes sonë kombëtare, doli si problem jetësor i kombit shqiptar, sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore,

^[2] AQSH, F. 270, 14, F.42 viti 1943

kur ishte bërë *de facto* bashkimi i një pjese të mirë të trevave të Shqipërisë Verilindore me shtetin amë. Kërkesa për vetëvendosjen e popullit të Kosovës, sipas parimit të Kartës së Atlantikut, u bë shprehje e vullnetit gjithëkombëtar, gjë që impononte e kapërcente edhe mospajtimet politike të grupeve kryesore të rezistencës. Edhe përfaqësuesit e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar në Mukje, megjithëse nuk e kishin në programin e tyre Shqipërinë etnike për arsye që tashmë dihen, nuk dolën kundër dëshirës dhe vullnetit gjithëshqiptar për një Shqipëri të bashkuar etnike dhe, më në fund, e pranuan këtë opsion. Në një letër të Miladin Popoviçit drejtuar Titos, në prag të Konferencës së Mukjes, shkruhet ndër të tjera se "e tanë Shqipëria asht e okupueme prej këtij problemi" [3].

Së gjashti, edhe situata ndërkombëtare në verën e vitit 1943 ishte më e favorshme. Koalicioni i madh antifashist po përparonte në luftën kundër nazifashizmit. Misionet aleate britanike kishin ardhur në Shqipëri dhe kishin kontaktuar si me Nacionalçlirimtaren, ashtu edhe me Ballin Kombëtar, kërkonin bashkëpunimin mes tyre në luftë kundër ushtrive të Boshtit dhe e mbështetnin atë luftë.

Për këto arsye, marrëveshja e bashkëpunimi gjithëshqiptar ishin plotësisht të mundshme.

Është merita e vetëdijes kombëtare, përgjegjësia dhe angazhimi i figurave të shquara shqiptare, që në këtë situatë të brendshme e të jashtme të favorshme, por edhe të rrezikshme për Shqipërinë, e kuptuan dhe e ndjenë nevojën e domosdoshme të bashkimit, e dëgjuan thirrjen për marrëveshje mbarëshqiptare dhe u përpoqën ta ngjiznin atë.

Mukja po trokiste në dyert e historisë shqiptare, se e kërkonte koha.

Pra, jo vetëm ekzistonin të gjitha premiset e bashkëpunimit e të bashkëveprimit ndërmjet dy grupimeve kryesore të rezistencës shqiptare, por, gjithashtu, ishin shprehur pozitivisht edhe drejtues kryesorë të këtyre grupimeve për një konferencë bashkimi.

U bënë mjaft takime e konsultime paraprake ndërmjet eksponentëve kryesorë të të dy organizatave, por elementët bashkues ishin Abaz Kupi dhe Ihsan Toptani.

Dokumenti më i rëndësishëm në rrugën drejt Mukjes ishte, pa

[3] AQSH, F. 14, D.26 ? V.1943

dyshim, ai i datës 18 korrik 1943, një mesazh i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar drejtuar Organizatës së Ballit Kombëtar, hartuar dhe firmosur nga Y. Dishnica, M. Gjinishi, A. Kupi dhe M. Peza, që shpreh parimet kryesore të Lëvizjes Nacionalçlirimtare mbi të cilat u arrit edhe mirëkuptimi. Ky dokument i rëndësishëm nuk është botuar më parë dhe është heshtur qëllimisht, sepse këto parime demokratike, si: lufta antifashiste ku të marrin pjesë gjithë atdhetarët pa dallim feje, krahine dhe ideje; moscenimi i pronës dhe i iniciativës private, zgjedhje të lira e demokratike pas shporrjes së pushtuesve etj. PKSh-ja i braktisi dhe shpalosi idetë e revolucionit komunist, përmbysjen me dhunë e gjak të sistemit shoqëror, konfiskimin e pasurisë private e moslejimin e iniciativës së lirë private, marrjen me armë të pushtetit qysh gjatë luftës pa zgjedhje të lira, pa lejuar asnjë alternativë tjetër politike. Madje i shpalli armiq e tradhtarë përfaqësuesit e shquar jo vetëm të Ballit Kombëtar në Mukje, por edhe përfaqësuesit e saj të “mandatuar me fuqina të plota” si Ymer Dishnicën, Mustafa Gjinishin, Abaz Kupin etj.

Sipas procesverbalit të mbledhjes, të dyja organizatat u përfaqësuan nga këta delegatë:^[4]

Delegacioni i Ballit Kombëtar

1. Z Av.Hasan Dosti d.v
2. Z.Mid’hat Frashëri d .v
3. Av.Thoma Orollogai d.v
4. Av.Skënder Muço d .v
5. Komandant Hysni Lepenica d.v
6. Prof.Isuf Luzaj d.v
7. Komandant Kadri Cakrani d.v
8. Major Rauf Fratari d.v
9. Prof.Nexhat Peshkëpia d.v
10. Av.Halil Mëniku d .v
11. Kom.Ismahil Petrela d.v
12. Prof.Vasil Andoni d .v

Delegacioni i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar

1. Major Abaz Kupi d.v
2. N/Kolonel Jahja Çaçi d.v
3. Kom.Myslim Peza vula
4. Dr.Ymer Dishnica d.v
5. Z.Mustafa Gjinishi d.v
6. Dr.Omer Nishani d.v
7. Dr.Sulo Bogdo d.v
8. Z.Stefan Plumbi d .v
9. Z.Shefqet Beja d.v
10. Z.Medar Shtylla d;v
11. Z.Haki Stërmilli d.v
12. Gogo Nushi d.v

^[4] AQSH, Fondi '40, Dosja 2, viti 1943

Pas një debati konstruktiv që zgjati dy ditë, u arrit Marrëveshja. Pika e parë e saj ishte krijimi i Komitetit “Për shpëtimin e Shqipërisë”. Atributet e tij të rëndësishme flasin për një zgjidhje të re politike, për një përgjegjësi, pjekuri dhe angazhim të madh kombëtar të forcave politike kryesore në Shqipëri. Ky ishte forumi i parë pluralist në Shqipëri, si forma më demokratike e qeverisjes së botës së qytetëruar. Kjo mënyrë organizimi do të shtrihej edhe në gjithë strukturat e bazës dhe do të unifikonte drejtimin, do të shmangte anësinë partiake, do të eliminonte përçarjen e antagonizmin, do të mënjanonte rrezikun e luftës civile, do të bashkonte në një front të përbashkët të gjithë shqiptarët pavarësisht nga bindjet politike, nga përkatësia partiake, fetare, krahinore, në luftë të përbashkët kundër okupatorëve dhe do të çelte udhën e demokracisë së vërtetë pluraliste përëndimore.

Në proklamatin e datës 3 gusht 1943, Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë paraqiti këtë program:

1. Luftë të përbashkët dhe të menjëhershme përbri Aleatëve të mëdhenj Anglisë, SHBA dhe Bashkimit Sovjetik, si edhe të popujve të shtypur kundra pushtuesit barbar, me divizën rilindëse “Ja vdekje, ja liri!”
2. Luftë për një Shqipëri të Pavarme, luftë për zbatimin e parimit të njoftun botërisht e të garantuara nga Karta Atlantike e vetëvendosjes së popujve, për një Shqipëri etnike.
3. Luftë për një Shqipëri të lirë, demokratike e popullore.

Komiteti për shpëtimin e Shqipërisë do të vazhdojë luftën tue udhëhequn popullin shqiptar në rrugën e sakrificës dhe të nderit deri në formimin e një qeverie provizore.

Forma e regjimit do të caktohet prej vetë popullit me anën e një Asambleje kushtetuese të zgjedhur me sufragh universal direkt.”^[5]

E veçanta e Kuvendit të Mukjes ishte trajtimi me përparësi dhe kompetencë i çështjes sonë kombëtare në krizë, veçanërisht i Kosovës. Në Mukje u bë përpjekja e parë kombëtare institucionale për zgjidhjen e çështjes së Kosovës sipas vullnetit të popullit shqiptar dhe në bazë të parimit universal të vetëvendosjes së kombeve.

^[5] AQSH, F.270, D.11, V.1943

Përfaqësuesit kryesorë të Ballit dhe ata të Nacionalçlirimtares u shprehën se e konsideronin bashkimin e Kosovës me Shqipërinë gjatë Luftës së Dytë Botërore vetëm të pjesshëm dhe të realizuar dhunshëm nga okupatorët fashistë për interesat e tyre. Por ata ndaheshin kur rrihnin të përcaktonin qëndrimin ndaj momentit aktualisht që po kalonte apo duhet të evoluonte ky proces.

Mid'hat Frashëri insistoi që çështja e Kosovës detyrimisht të trajtohej e të përcaktohej në këtë kuvend dhe të luftohej për zgjidhjen e saj të drejtë, sepse, nëse nuk do të ndodhte kështu, atëherë, pas luftës, as që do të përmendej më çështja kosovare dhe Kosova do të ishte e humbur. Ai parashtrroi që zgjidhja e statusit të saj të bëhej mbi parimin e vetëvendosjes së kombeve, të garantuar nga Karta e Atlantikut.

Ky formulim respektonte vullnetin e popullit shqiptar për vetëvendosje dhe përjashtonte ndryshimin e kufijve me dhunë apo bashkimin nëpërmjet okupatorëve fashistë. Gjithashtu, ai harmonizohej edhe me politikën e Fuqive të Mëdha Antifashiste që kishin shpallur botërisht se nuk njihnin kufijtë e ndryshuar me dhunë nga pushtuesit nazifashistë, pra ishte njëherësh edhe një pohim edhe një bashkërrësim në Frontin Antifashist Ndërkombëtar.

Vendimet e Konferencës së Mukjes ishin të qenësishme, jo vetëm për momentin historik, por edhe për ardhmërinë e Shqipërisë e të kombit shqiptar, sepse ato konfirmonin bashkimin dhe jo ndarjen, siguronin luftë të përbashkët kundër çdo okupatori, për një Shqipëri të lirë e të pavarur, mundësonin në të ardhmen një Shqipëri demokratike dhe rreshtimin përbri Aleatëve të mëdhenj antifashistë, por edhe përcaktonin rrugën më të drejtë për zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare.

Pra, një program kombëtar e demokratik.

Ky program i përbashkët u arrit, pasi të dyja përfaqësitë u treguan tolerante dhe i bënë lëshime njëra-tjetrës. Në këtë pikë, Mukja është edhe shembull i mendimit e i veprimt demokratik si pjesëmarrje, bisedim konstruktiv e tolerancë të admirueshme, një kompromis e një zotim i përbashkët. Është një model i dialogut kombëtar, i debatit dhe i mirëkuptimit. Aleanca që u arrit në Mukje, premtonte se edhe në të ardhmen forcat politike shqiptare do të merreshin vesh midis tyre për çështjet themelore. Ky shembull

është i dobishëm për sot dhe për nesër.

Mukja ishte triumfi i shqiptarizmit mbi nacionalshovinizmin dhe internacionalizmin proletar, i ndërgjegjes dhe i veprimit kombëtar mbi atë antikombëtar, i drejtimit progresist perëndimor mbi atë lindor, aziatik e bizantin, i platformës thellësisht demokratike mbi atë totalitare, fashiste apo komuniste.

Menjëherë pas Konferencës së Mukjes, Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë organizoi në datat 4 dhe 5 gusht 1943 një betejë të përbashkët në afërsi të Qafë-Shtamës kundër ushtrisë italiane, që marshonte për në Mat.

Proklamata 1^[6]

“Çetat vullnetare partizane të Ushtrisë NÇ dhe çetat e Ballit Kombëtar nën komandën e majorit Abaz Kupi më datën 4 të gushtit 1943, në orën 10.00, mbasi muarën vesh se ushtria italiane shkante për në Mat, u nisën për t’i prerë rrugën në të gdhirë. Kur çetat mbërritën në këtë vend, ushtria armike, mbasi dogji disa shtëpi që ndodheshin afër rrugës si dhe komunën dhe zyrën e botores, kaloi dhe po i afrohej Qafë-Shtamës. Mbasi çetat nuk mund të arrinin në kohë, në ato pozita ku do t’i pritnin, u detyruan të ecnin gjithë natën dhe, si kaluan malin e Liqenit, i dolën përpara në kufirin e Matit, dy km afër Qafë-Shtamës.

Plot në orën 7.10 të ditës së nesërme, ushtria italiane e përbërë prej 750 vetave, mbërriti në vendin e pritjes e përnjëherësh filloi luftimi, i cili zgjati 3 orë rresht dhe mbaroi me shpartallimin e plotë të ushtrisë armike.

Humbjet e armikut janë: 150 të vrarë, 40 të plagosur, 7 robër. Në mes të të vrarëve italianë është edhe oficeri kolonel A.P.Scarpa, të cilit i është gjetur në xhep një medalje të fituar kur ka hyrë në tokën shqiptare ditën e 7 prillit 1939. Është kapur një material kolosal. Të numëruar deri tani janë: një mortajë e rëndë me gjithë municione, 6 mitroloza të rëndë komplet me municione, 10 mitralozë të lehtë dhe mjaft municione për to, 160 armë luftime, 7 radio fushore marrëse-dhënëse, 5 kuaj. Gjithashtu janë marrë revolverë, materjal sanitar, batanije e materiale të tjera të ndryshme.

Humbjet tona janë një i vrarë dhe dy të plagosur”.

^[6] AQSH, F. 270, D. 11 v. 1943

Komiteti për shpëtimin e Shqipërisë

Kjo luftë, dy ditë pas Mbledhjes së Mukjes, tregoi se kjo nuk ishte një shprehje historike, por një realitet, nuk ishte vetëm një marrëveshje në letër, por edhe një marrëveshje konkrete për bashkëpunim në luftë, nuk ishte një tradhti që, sipas E. Hoxhës - binte ndesh me interesat e Luftës antifashiste, "por ishte një lidhje bese në dobi të luftës çlirimtare dhe të çështjes kombëtare, nuk ishte një gjë "formale" e një "grackë" - siç thoshte E. Hoxha, po një vendim e një veprim i vullnetit të një populli; ishte, në fund të fundit, një ndërgjegje e kthyer në lëvizje e forcave partizane dhe atyre nacionaliste, që luftuan së bashku si shqiptarë e si vëllezër kundër okupatorëve, nën drejtimin e Komitetit Provizor për Shpëtimin e Shqipërisë.

Udhëheqja e PKSh-së, nën presionin e emisarëve të PKJ-së në Shqipëri, prishi dhe shkeli në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare Marrëveshjen e Mukjes.

Kjo marrëveshje prekte sidomos interesat dhe synimet e qarqeve shoviniste serbomëdha që sundonin në PKJ, të cilat kërkonin përjetësimin e pushtimit serb të Kosovës e të viseve të tjera shqiptare, si edhe nënshkrimin e plotë të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë. Prandaj edhe prishja e njëanshme e Marrëveshjes së Mukjes ishte kryesisht rezultat i ndërhyrjes jugosllave, të cilës nuk i interesonte kurrsesi marrja dhe plotësimi i atyre vendimeve. Reagimi i shpejtë e i vendosur i kolonit malazez në Kosovë, M. Popoviçit, ishte i kuptueshëm. Kur aktet e marrëveshjes së Mukjes iu dorëzuan "mentarit" të Enverit, ai i tërbuar i grisi ato, i bëri copë-copë dhe ia hodhi në surrat Enver Hoxhës.^[7]

Kjo ndërhyrje brutale e Partisë Komuniste Jugosllave në punët tona të brendshme vërtetohet edhe nga një letër që udhëheqësi real i PKSh-së, M. Popoviçi, i dërgoi Titos: "Kemi ndikuar në PKSh dhe në LNÇl që gjithsesi të prishim Marrëveshjen e Mukjes."^[8]

E. Hoxha, nën diktatin e M. Popoviçit, me të cilin ishte në Vithkuq, pa përfillur Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, i cili kishte nënshkruar me Ballin Kombëtar Marrëveshjen e Mukjes dhe i kishte kërkuar gjithashtu Ballit Kombëtar, më 7 gusht 1943,

[7] V.Dedijer, Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare

[8] AQSH, F.14, D.5 v. 1943

shtytjen e afatit për 6 ditë derisa të caktonte përfaqësuesit e tij në Komitetin Definitiv, pra, pa mbledhur dhe pa marrë mendimin e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, më datën 8 gusht 1943, si një partiak, u dërgoi një letërqarkore shokëve të partisë së Vlorës, Gjirokastrës etj: "Lajmëroheni se ju është dërguar nga Tirana një trakt për t' u shpërndarë, i firmosur prej Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, ku flitet për bashkimin e plotë të arritur në mes të KNÇL dhe Ballit Kombëtar. Ky trakt është në kundërshtim me vijën nacionalçlirimtare dhe disaprovohet nga KQ i Partisë. Prandaj, në rast se nuk i keni shpërndarë, çirrini dhe të mos flitet më për të." [9]

Shkak tjetër për prishjen e njëanshme të Marrëveshjes së Mukjes ishte çështja e pushtetit. Synimi i pushtetit është një akt normal në çdo kohë, por vendimi i PKSh-së për ta marrë pushtetin me dhunë e me gjak, duke shkelur edhe vendimin e Mukjes se çështja e pushtetit do të zgjidhej pas luftës me zgjedhje demokratike. Kjo solli edhe luftën civile në Shqipëri, pasoja më tragjike e prishjes së Marrëveshjes së Mukjes.

Po të mos ishte prishur kjo marrëveshje, Shqipëria do të ishte sot një nga vendet më të zhvilluara të Europës. Pasoja e prishjes së saj ndihen edhe sot.

Mukja u tradhtua, por nuk vdiq. Fryma e saj, shpirti i saj jetoi gjatë Luftës, gjatë periudhës gjysmëshekullore të diktaturës dhe erdhi te ne si mesazh i bashkimit, i mirëkuptimit dhe i ardhshmërisë demokratike.

Mesazhi i saj është gjithnjë aktual: Shqiptarë, e mira dhe interesi i Shqipërisë, i kombit shqiptar dhe i çdo shqiptari kërkon mirëkuptimin e bashkimin e jo ndarjen dhe armiqësinë.

Bashkimi është akti i parë i çlirimit të një kombi.

[9] AQSH, F 14, D.11, v. 1943